
SHTOJCA 2

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE (sipas udhëzimit administrativ 04/2022) **Vazhdim i Lejes Mjedisore Nr.16/3124/548/DMMU**		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. **Të dhënat për Operatorin**		
1.1.1.	Emri i subjektit	"ETEM TRADE"Sh.p.k.
	Vendi	Petrovë - Prizren,
	Adresa	Petrovë - Prizren,
	Nr. i tel./fax	+38344 113 397
	E-mail	etemtrade@hotmail.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810600884, 10/05/2007
1.1.3.	Personi kontaktues për mjedis	Samet Badalli **Drejtor i kompanisë**
	Nr. i tel./fax	+38344 113 397
	E-mail	etemtrade@hotmail.com
1.4.4.	Personi kontaktues përgjegjësf për mjedis	Samet Badalli
	Nr. i tel./fax	+38344 113 397
	E-mail	etemtrade@hotmail.com


1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	"ETEM TRADE " Sh.p.k.
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Petrovë- Prizren
2.	TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT	
2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Ngastrat kadastrale Nr. 182 dhe 184, ndodhen në zk. Petrovë- Prizren , pjesa e ngastrave ne fjale eshtë pasuri private. Sipërfaqja e ngastrave në të cilat ndodhet gurthyesi me seperacion është S= 1 ha 72,28 ari



Lokacioni ku eshtë duke, bluar guri dhe seperuar ndodhet në Petrovë- Prizren. Hulumtimi dhe vleresimi eshtë bere duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bera ne ketë tëren. Per tu definuar gjendja ekzistuese ne menyre të kenaqshme dhe per tu krijuar baze

		reale per hulumtim të ndikimeve të mundshme ne kuader të gjendjes, jane prezantuar edhe të dhenat relevantë qe kane të bejne me të dhenat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike, hidrografike dhe metëorologjike. Bazuar ne të dhenat e mesiperme, del se lokacioni i bazes per prodhimin e betonit, bluarjes dhe seperimit të gurit gjendet ne lokalitëtin Petrovës në zonën e kualifikuar si zone industrial në rrugën tranzit Suharekë-Prizren ne mes të lokaliteteve të banuara në jug-lindje fshati Petrovë I cili ndodhet ne nje distance mjaft të larget , në anën perendimore lagja Arbana (Dushanova). Kjo zone bazuar ne vrojtimet e tërrenit del se posedon kushtë optimale ekologjike, gjeologjike, hidrografike per zhvillimin e veprimtarise se lartëshenuar per shfrytëzimin e argjilave. kompania ka lejen e shfrytezimit te kesaj parcelle nga

		Komuna e Prizrenit per eksploatimin e argjilave. Prandaj ndikimet kryesore të mundshme në mjedis janë në ajër,ujë,tokë dhe ndikimet nga zhurma. Të gjitha ndikimet tjera janë të pa përfillura. Këto ndikime janë të paraqitura në pikat 2.3.1, 2.3.2, 2.3.3, 2.3.5. të Aplikacionit për dhënien e Lejes Mjedisore Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokalitetit janë bazë themelore për hartimin e raportit. Hulumtimi dhe vlerësimi është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren.Ky impiant bazuar në vrojtimet e terrenit del se posedon kushte optimale ekologjike, gjeologjike, hidrografike për zhvillimin e veprimtarisë së lartëshënuar për bluarjen e seperimin e gurit gëlqeror . Kjo ortofoto e treguar më poshtë e rajonit të gjërë, tregon lokalitetin e ngastrës për të cilën kompania "ETEM TRADE " Sh.p.k kërkon vazhdimin e Lejes Mjedisore. Siq shihet në orto foto , ky lokalitet është i zhveshur


		me një bimësi të ulët.Në kopjen e planit që do tia bashkangjesim këtijë raporti do ti shënojmë edhe koordinatat e pikave kufizuese.Në këtë lokalitet është e rregulluar infrastruktura rrugore të cilën do ta shfrytëzojë kompania "ETEM TRADE " Sh.p.k 
2.2	Nr. Kadastral i parcelës	Nr i njësisë kadastrale Nr. 182 dhe 184 me **S=1ha72,28 ari**

2.3.	Përshkrimi i lokacionit , të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	Kjo ndërmarrje ka selin në objektin i cili shtrihet në njesin kadastrale , Nr. 182 dhe 184 me S=1ha72,28 ari zk. petrovë-Prizren, pronë private në emër të 1) Izer Badalli 2) Selajdin Badalli 3) Yrjet Badalli 4) Etem Baballi 5) Muhamet Badalli Marrur në shfrytzëzim nga kompania "ETEM TRADE" Sh.p.k. me pronar Samet Badalli,.
2.4	Të dhënat lidhur me florën dhe faunën në këtë lokacion	Siq shihet në orto foto , ky lokalitet është i zhveshur sepse kjo zonë ka karakterin e zonës industriale në të cilën operojnë shumë biznese të tjera. Tokat janë ranore të shkrifta e cila mundë të ofron kushte optimale për zhvillimin e bimësisë. Në lokacionin ku punohet kemi të bëjmë me një degradim të florës dhe faunës mirëpo me ndërprerjen e aktivitetit punues në këtë lokacion kompania është e obliguar që sipas raportit të rikultivimit , këtë lokacion ta kthej në gjendjen e mëparshme dhe ta përshtatë me ambientet rrethuese.

		Sa i përket faunës në këtë lokacion nuk ka diçka të veqant sepse edhe rrethina është tokë e punuar dhe nuk ka kushte që ky lokacion të strehoj kafshë të egra sepse zona është e tillë që shumë kompani operojnë në rethinë.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta apo të mbrojtuna	Në këtë lokacion nuk kemi zona me status të veçant apo zona të mbrojtuna me ligj.

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË		
3.1.Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore		
3.1.1.	Skema e procesit teknologjik	
3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	**Procesi teknologjik**


Përshkrimi i punës së gurthyesit me seperacion



Projekti teknologjik për Bluarje , Thyerje dhe Seperim të frakcionit në hyrje(60 mm) nga guri gëlqeror


Projekti do të punohet tërsisht sipas dispozitave ligjore, rregulloreve dhe standardeve për objekte

		investive tekniko-teknologjike , I cili në bazë të detyrave projektuese përbëhet nga: 1.Fortina (Bunkeri) me kapacitet pranues (10)m^3 2. Mullini me çekiça (7 rende x 4çekiça = 28 çekiça)9 f. el. 45 kW) 3. Sita primare vibruese (1 x 3 m) 4. Shiriti kryesor transportues I frakcionit për bluarje(60 mm) 5. Shiritat transportues për frakcionet e seperuara 0-2mm; 0-4mm; 8-16mm.(kthehet për ribluarje) **Fortina (Bunkeri pranues)** Pothuajse te të gjitha linjat e gurëthyesve pozita e pare nga e cila fillon proqesi teknologjik I bluarjes dhe seperimit të gurit gëlqeror apo në përgjithësi të gurve të forte është bunkeri pranues I gurit të sjellur nga kompanitë tjera. Në linjën e kompanisë "ETEM TRADE bunkeri pranues ka një kapacitet afro 10 m^3 në të cilin ngarkohet materiali 60mm për tu bluar dhe seperuar në frakcionet e vevojshme për kompaninë. Fortina në pjesën e poshtme ka formën e hinkës me një hapje në fund të hinkës nga e ila hapje materiali i ngarkuar në fortinë me ramjet ë lirë bie në shiritin transortues dhe përmes shiritit transportues në

		mullinin me çekiça.  Siç shihet ky shirit është I përbër nga një rrul i vendosur horizontal me një kënd pjerrtësie të shiritit 17-21 ° . Shiriti I gomës në këtë pozicion duhet të jetë minimum tre shtresorë sepse u nënshtrohet të gjitha presioneve dhe ngarkesave të ndryshme përshkak se

		bënë transportimin e materialit që del nga mulliri primar. Forca e el. e cila e vë në lëvizje shiritin transportues varet nga gjatësia e shiritit dhe këndi I pjerrtësisë dhe kjo fel. nuk guxon të jet nën 2.5 kW kurse reduktori duhet të ket 60 rrot/ min. Nga ky shirit materiali I thërmuar 0-60 mm , kalon në mullirin primar me çekiça për tju nënshtruar procesit të ma tutjeshëm të thërmimit.

		Mullini me çekiça (prodhim zejtar) me katër rende me nga shtat çekiça gjithësejt 24 çekiça (1,5 kg secili). Një mulli I vogël por funksional I cili përmbushë nevojat e kompanisë në prodhimin e elementeve nga betoni. 



Mullini me çekiça

Sita primare vibruese

Materiali I cili thërmohet në mullirin me çekiça permes shiritit transportues shkon në sitën primare vibruese katër katëshë në të cilën bëhet ndarja e frakcioneve sipas gabariteve. Në këtë site bëhet ndarja e frakcioneve 0-2 mm; 0-4 mm; dhe materiali mbi site I

		cili prap kthehet në procesin e ribluarjes. këto frakcioneve permes shiritave gjegjës transportues deponohen nëpër vende të caktuara kurse materiali mbi site gabaritet e të cilit janë 8; 16 dhe 32 mm dhe në mënyrë ciklike materiali I cili është mbi 16 mm prap kthehet në ribluarje në mullirin me çekiça. **Sita primare vibruese** 

3.1.3	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	Kompania I.M.N. "ETEM TRADE " Sh.p.k. takimin me punëtorë e bënë në objektin e fabrikës në orën 7:00, për tlë marrur instruksionet ditore të punës, më pastaj punëtorët sistemohen nëpër vendet e punës kurse në gurthyes punojnë nga ora 8 deri në ora 17dhe për 9 orë , orari ede mundë të ndryshoj sepse mvaret nga nevoja e lëndës së parë në procesin e prodhimit . Orari I punës zgjatet por gjithnjë në marrveshje me punëtorët duke pasur parasyshë edhe pjesën stimulative të punëtorve kur punohet jasht orarit. Numri i të punësuarve në bazën e beonit dhe gurthyes është 8.
3.1.4	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Kapaciteti teorik ndryshon nga ai praktik. Nuk mundë të flitet për ndonjë projektim fiks të kapacitetit të prodhimit. Ndër kushtet e imponuara është se gjithmonë prodhohet sipas kërkesave të fabrikës në fazën e prodhimit të betonit dhe elementeve nga

		betoni. Arsyeja: Natyra e punës, pengesat e ndryshme gjatë punës. Kapaciteti praktik realizohet në masën 70-80 % të atij teorik, kurse prodhimi ditor, mujor dhe vjetor në këtë impiant varirojnë sepse prodhimi varet nga shumë faktorë siç janë: 1. Gjendja teknike e impiantit 2. Nevoja apo kërkesa e tregut si dhe 3. Kualiteti i lëndës së grumbulluar(frakcioneve).
3.1.5	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse.	• Guri i minuar: Guri , Nafta karburant të cilën mjetet transportuese e shfrytëzojnë si lëndë djegëse. Për nevojat e veta kompania furnizohet nga pika e karburantit "ARBËRIA" në afërsi të kompanisë ETEM TRADE Të gjitha pajimet në gurthyes me seperacion punojnë me energji elektrike për të cilën kompania ka kontratë me KEDS-in. Uji përveq prodhimit të betonit dhe nevojave sanitare

		përdoret edhe për rrëzimin e pluhurit që shkaktohet gjatë punëve operative brenda objektit dhe transportit edhe pse kjo sasi është shumë e vogël pothuaj e papërfillshme. Kompania ujin e merr nga pusi të cilin e posedon brenda objektit.
3.1.6	Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre	Kompania nuk ka rezervoar të cilin e përdor në gurëthyes.
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	Si bazë ligjore për hartimin e këtijë projekti , kompania shfrytëzon këto ligje dhe udhëzime administrative. Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është në përputhje me normativat evropiane të mbrojtjes së tij, ndonëse cilësia mjedisore është ende në parametra mjaft të ulët. Ligji i parë për mbrojtjen e mjedisit daton ne vitin 2003, tani i hartuar Ligji i ri për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, në të cilin pos tjerash potencohet se të gjitha veprimtaritë e personave fizik

		dhe ligjor, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari të reja dhe kanë ndikime të theksuara negative në mjedis, do të jenë temë e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit apo mënjanimit të efekteve negative neë mjedis në kohën e duhur.

		Ligjet • Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 • Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 • Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 • Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110 • Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-160 • Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174 • Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26 • Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233 • Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 **Udhëzimet Administrative** • Udhëzimi administrativ Nr.04/2022 për Lejen Mjedisore • Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2007 mbi

		rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes • Udhëzimi administrativ për administrimin e mbeturinave të rrezikshme (06/2008) • Udhëzimi administrativ Nr. 20/2012 për export, import dhe transit të mbeturinave • Udhëzimi administrativ kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave (08/2 Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme • Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për metodologjinë e zvoglimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat per eliminimin e pasojave. • Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës.

		• Udhëzimi administrativ për menaxhimin e deponive të mbeturinave(15/2012) • Udhëzimi administrativ.Nr.30/2014 përkushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujrave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor.
3.2.	Menaxhimi i mbrojtjes së Mjedisit	

3.2.1.	Menaxhimi i mbrojtjes së Mjedisit	Kompania ka një kuadër profesional të të punësuarish prandaj edhe bënë një menaxhim të mbrojtjes së mjedisit. Transsportit të lëndës minerale (guri në formë frakcioni 30-60mm) nga gurthyesit tjerë për ta ribluar në frakcione sipas nevojave të kompanisë, për të evituar emitimin e pluhurit në hapësirë, kompania përdorë ujin si mjet për ta rrëzuar pluhurin në sipërfaqën punuese gjatë sezonës së nxehtë. Pluhurin e rrëzon përmes spërkatjes me anë të autocisternës. Kompania do të caktojë një person përgjegjës për mbrojtjen e

		mjedisit, i cili do të ketë përgjegjësi për: • zbatimin e Planit të Menaxhimit Mjedisor; • monitorimin e parametrave mjedisorë; • mbajtjen e evidencës për mbetjet, emetimet dhe incidentet; • organizimin e trajnimeve për punonjësit; • bashkëpunimin me autoritetet kompetente. **Menaxhimi i cilësisë së ajrit** Për reduktimin e pluhurit dhe emetimeve do të zbatohen këto masa: • lagia periodike e rrugëve të brendshme dhe e grumbujve të agregateve; • mbulimi i materialeve të imëta kur është e nevojshme; • kufizimi i shpejtësisë së automjeteve brenda lokacionit; • mirëmbajtja e rregullt e makinerive dhe automjeteve; • monitorimi periodik i PM_{10} dhe $PM_{2.5}$. **Menaxhimi i ujërave** • Ujërat nga larja e mikserëve dhe pajisjeve do të

		grumbullohen në pellg sedimentimi. • Uji i trajtuar do të riciklohet në procesin teknologjik, kur kjo është teknikisht e mundur. • Nuk do të lejohet shkarkimi i ujërave të patrajtuara në mjedis. • Do të mirëmbahen kanalet kulluese dhe sistemi i drenazhimit. **Menaxhimi i tokës** • Zonat e furnizimit me karburant dhe mirëmbajtjes së makinerive do të jenë të papërshkueshme nga lëngjet. • Në rast rrjedhjesh të vajrave ose karburanteve do të përdoren materiale absorbuese dhe do të largohet toka e ndotur. • Do të parandalohet depozitimi i pakontrolluar i materialeve. **Menaxhimi i mbetjeve** Mbetjet do të ndahen sipas kategorive: • mbetje inerte (beton, agregate);

		• mbetje komunale; • mbetje metalike; • ambalazhe plastike dhe letre; • vajra dhe filtra të përdorur (nëse krijohen). Të gjitha mbetjet do të ruhen përkohësisht në zona të përcaktuara dhe do t'u dorëzohen operatorëve të licencuar. **Menaxhimi i zhurmës** • Mirëmbajtja e pajisjeve për të reduktuar zhurmën. • Kufizimi i punës në oraret e lejuara. • Monitorimi periodik i nivelit të zhurmës. • Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse nga punëtorët. **Menaxhimi i gjelbërimit** • Mbjellja e brezave mbrojtës me pemë dhe shkurre përgjatë kufijve të lokacionit. • Mirëmbajtja e vazhdueshme e sipërfaqeve të gjelbëruara. • Zëvendësimi i bimëve të dëmtuara. **Monitorimi mjedisor**

		Do të monitorohen: • cilësia e ajrit; • niveli i zhurmës; • cilësia e ujërave; • gjendja e tokës; • menaxhimi i mbetjeve; • konsumi i ujit dhe energjisë; • incidentet mjedisore. Rezultatet do të regjistrohen dhe do të raportohen sipas kërkesave të autoriteteve kompetente.
3.2.2	Raportimi	Raportimi është një element i rëndësishëm i sistemit të menaxhimit mjedisor dhe ka për qëllim dokumentimin e rezultateve të monitorimit, vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitetit me kërkesat ligjore dhe informimin e autoriteteve kompetente mbi performancën mjedisore të projektit. Për projektin e **gurthyesit me seperacion në ngastrat kadastrale nr. 182 dhe 184, Zona Kadastrale Petrovë, Komuna e Prizrenit**, kompania do të zbatojë procedurat e

		mëposhtme të raportimit: □ Do të mbajë evidencë të vazhdueshme për monitorimin e cilësisë së ajrit, nivelit të zhurmës, menaxhimit të ujërave, mbetjeve dhe çdo parametri tjetër të përcaktuar në Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe në Pëlqimin Mjedisor. □ Të gjitha rezultatet e monitorimit do të regjistrohen në formularë dhe regjistra zyrtarë, të cilët do të ruhen si pjesë e dokumentacionit të kompanisë. □ Do të përgatiten raporte periodike mbi gjendjen mjedisore të projektit, të cilat do të përfshijnë rezultatet e matjeve, analizën e tyre, krahasimin me standardet ligjore, incidentet mjedisore (nëse ka) dhe masat korrigjuese të ndërmarra. □ Raportet do t'u dorëzohen institucioneve kompetente në afatet dhe format e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e Pëlqimit Mjedisor. Në rast të një incidenti mjedisor, si rrjedhje e karburanteve ose vajrave, ndotje e ujërave, tejkalim i vlerave kufitare të emetimeve ose ngjarje tjetër që mund të ndikojë në mjedis,

		kompania do të njoftojë menjëherë autoritetet kompetente dhe do të dokumentojë shkakun, pasojat dhe masat e ndërmarra. □ Dokumentacioni i raportimit do të ruhet për periudhën e përcaktuar nga legjislacioni dhe do të vihet në dispozicion të organeve inspektuese gjatë kontrolleve zyrtare. Raportimi i rregullt do të mundësojë monitorimin e vazhdueshëm të ndikimeve në mjedis, rritjen e transparencës, përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore të aktivitetit të seperacionit.

4. AJRI		
4.1.	Pikat e burimit të emisioneve të materieve ndotëse	Në aktivitetin e **seperacionit**, burimet kryesore të emisioneve të materieve ndotëse lidhen me proceset e pranimit, magazinimit, dozimit, bluarjes dhe seperimit të gurit, si dhe me funksionimin e makinerive dhe automjeteve. Identifikimi i këtyre burimeve është i

		rëndësishëm për planifikimin e masave të kontrollit dhe monitorimit mjedisor. Pika të mundëshme të burimit të pluhurit janë: **Zona e pranimit dhe shkarkimit të agregateve** Emetim pluhuri (TSP, PM_{10} dhe $PM_{2.5}$) gjatë shkarkimit të rërës dhe zhavorrit. **Depoja e agregateve** Emetim pluhuri nga era dhe gjatë manipulimit me ngarkues. **Transportuesit me shirita (konvejerët)** Shpërndarje pluhuri në pikat e transferimit të materialit. **Bunkerët dhe sistemi i bluarjes** Pluhur gjatë furnizimit dhe bluarjes dhe seperimit të gurit të minuar. □ **Rrugët e brendshme të qarkullimit** Pluhur i ngritur nga lëvizja e automjeteve dhe makinerive. **Automjetet dhe makineritë punuese** • Emetime të gazrave të djegies (CO_2, CO, NO_x, SO_2, PM dhe hidrokarbure) nga motorët me naftë. **Burimet e emisioneve në ujë** • Ujërat e rrjedhjes nga sipërfaqet e punës. • Ujërat atmosferike që kalojnë nëpër zonat e depozitimit të materialeve. **Burimet e ndotjes së tokës**

		• Rrjedhje të mundshme të karburanteve, vajrave dhe lubrifikantëve. • Depozitimi i pakontrolluar i mbetjeve. • Derdhja aksidentale e betonit të freskët ose llaçit. **Burimet e zhurmës dhe dridhjeve** • Makineria për bluarje dhe seperim • Ngarkuesit dhe ekskavatorët. • Kamionët gjatë hyrjes, daljes dhe ngarkim-shkarkimit. • Kompresorët dhe pajisjet ndihmëse. **Masat për kontrollin e emisioneve** Për minimizimin e emisioneve të materieve ndotëse do të zbatohen këto masa: • lagia periodike e rrugëve të brendshme dhe e depozitave të agregateve; • mbulimi ose mbrojtja e materialeve të imëta nga era; • mirëmbajtja e rregullt e makinerive dhe automjeteve; • kufizimi i shpejtësisë së automjeteve brenda lokacionit; • pastrimi i rregullt i sipërfaqeve të punës; • monitorimi periodik i emisioneve në përputhje me programin e monitorimit mjedisor.
4.2.	Ndikimi i materjeve ndotëse në cilësinë e ajrit	Duke pasur parasysh teknologjinë e avansuar në këtë objekt si dhe sistemin e ujit të instaluar nëpër pikat kyqe ku konsidereohet se mundë të shkaktohet pluhur, mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë rajon është në

		nivel të lakmueshëm dhe nuk ka ndonjë shkak që do të ndikonte në ndotjen e ajrit . Ndotje e ajrit ndodhë nga pluhuri i cili shkaktohet gjat zbrazjes së gurëve të minuar në bunker dhe nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet transportuse (gjatë procesit të ngarkimit dhe shkarkimit). Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër kompania ka sistemin e spërkatjes me ujë, rrugët në të cilat operon kompania duhet të spërkatën me ujë. Në këtë mënyrë niveli I pluhurit në ajër bie në nivel i cili nuk paraqet rrezik për mjedisin.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive janë emisione që nuk shkarkohen përmes një oxhaku ose sistemi të kontrolluar, por lirohen në mënyrë të shpërndarë gjatë proceseve të punës. Burimet difuzive të emisioneve në impiantin e gurëthyesit me seperacion lidhen kryesisht me manipulimin, magazinimin dhe transportin e agregateve të prodhuara, si dhe me qarkullimin e automjeteve dhe makinerive brenda

		lokacionit. Ndotësit kryesorë janë pluhuri total i pezulluar (që fluturon në ajër), grimcat PM_{10} dhe $PM_{2.5}$, si dhe gazrat e shkarkimit nga motorët me djegie të brendshme (CO, NO_x, PM dhe CO_2). Për minimizimin e këtyre emisioneve zbatohen masa teknike dhe organizative, përfshirë spërkatjen me ujë të sipërfaqeve dhe grumbujve të materialeve, kufizimin e shpejtësisë së automjeteve dhe mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve dhe makinerive. Këto masa kontribuojnë në mbajtjen e emisioneve brenda kufijve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Në gurthyes me seperacion burimi kryesor i emetimeve në ajër është pluhuri (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$), i cili krijohet gjatë bluarjes dhe seperimit të gurit, transportit dhe seperimit të agregateve. Gazrat e djegies krijohen nga automjetet, ngarkuesit dhe, nëse ka, gjeneratorët ose kaldajat. Për trajtimin e gazrave dhe pluhurit përdoren këto pajisje: • **Sisteme të spërkatjes me ujë** në deponitë e agregateve, në pikat e ngarkim-shkarkimit dhe në

		rrugët e brendshme. • **Mbulesa ose transportues të mbyllur** për materialet pluhurore. • **Mirëmbajtje e rregullt e motorëve** dhe përdorimi i karburantit cilësor për uljen e emetimeve të CO, NO_x dhe grimcave. Për reduktimin e pluhurit nga manipulimi i agregateve dhe qarkullimi i automjeteve përdoret sistem i spërkatjes me ujë në zonat e ekspozuara. Gazrat e shkarkimit nga automjetet dhe makineritë e punës kontrollohen nëpërmjet mirëmbajtjes periodike të motorëve dhe respektimit të standardeve të emetimeve, duke minimizuar çlirimin e CO, NO_x, hidrokarbureve dhe grimcave në atmosferë.
4.5.	Pajisjet për depluhërim	Për reduktimin e emisioneve difuzive përdoret sistem i spërkatjes me ujë në depot e agregateve, në pikat e ngarkim-shkarkimit dhe në rrugët e brendshme të impiantit. Transportuesit dhe pikat e transferimit janë të mbuluara

		ose të mbyllura për të kufizuar përhapjen e pluhurit në mjedis. • Sistem spërkatjeje me ujë për depot e agregateve dhe rrugët e brendshme. • Transportues të mbyllur për materialet pluhurore. Ky konfigurim konsiderohet praktikë standarde për kontrollin e pluhurit në impiantet moderne të prodhimit të frakcioneve të zallit dhe ndihmon në përmbushjen e kërkesave të legjislacionit mjedisor
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Monitorimi i emisioneve në ajër do të kryhet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe kushtet e lejes mjedisore. Parametrat kryesorë të monitorimit përfshijnë pluhurin total të pezulluar(pluhur i cili fluturon në ajër) ,PM_{10}, $PM_{2.5}$ dhe, sipas rastit, CO dhe NO_x nga burimet e djegies. Monitorimi do të realizohet nga laboratorë të akredituar, ndërsa kontrolli i përditshëm i sistemeve të depluhërimit, filtrave dhe spërkatjes me ujë do të kryhet nga operatori i impiantit. Rezultatet do të

		dokumentohen, ruhen dhe do t'u raportohen autoriteteve kompetente sipas kërkesave të lejes mjedisore. Në rast të tejkalimit të vlerave të lejuara, do të zbatohen menjëherë masa korrigjuese dhe do të kryhet monitorim verifikues për të konfirmuar rikthimin e emisioneve në nivelet e pranueshme.
4.7.	Monitorimi i emisioneve të cilësisë së ajrit	Monitorimi i cilësisë së ajrit do të kryhet në mënyrë periodike në kufirin e impiantit dhe në pikat më të ekspozuara ndaj emisioneve, duke përfshirë matjen e pluhurit total të pezulluar (TSP), grimcave PM_{10} dhe $PM_{2.5}$, si dhe, kur ka burime të djegies, gazrave CO dhe NO_x. Matjet do të realizohen nga laboratorë të akreditуar sipas standardeve përkatëse. Paralelisht, operatori do të kryejë kontrolle të rregullta të filtrave, sistemit të aspirimit dhe sistemit të spërkatjes me ujë. Të gjitha rezultatet do të dokumentohen dhe do të raportohen autoriteteve kompetente
4.8	Raportimet	Nuk ka ndonjë raport të veçant

4.9.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	Për të parandaluar dhe zvogëluar sasin e ndikimeve në ajër të krijuar gjatë realizimit të bluarjes dhe seperimit duhet të ndërmerren këto masa: ❖ Bëhet spërkatja me ujë e të gjitha siprfaqeve operacionale , rrugëve të pa asfaltuara nëpër të cilat bëhet edhe transporti i lëndës së grumbulluar. ❖ Bëhet kontrollimi i rregullt teknik i paisjeve teknologjike në mënyrë që gazrat që lirohen nga këto makina të jenë sa më pak të ndotura. ❖ Kamionët e transportit të lëndës mbulohen gjat trnsportit të lëndës ❖ Kompania çdo herë, cisternën e ka të mbushur me ujë dhe të gatshme për punë.
5. UJI		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Kompania për ti plotësuar nevojat e vete me ujë(për rrëzimin e pluhurit, spërkatjen e hapësirave operacionale dhe për nyjet sanitare), ka të shpuar një pus nga i cili

		përmes pompës elektrike bënë nxjerrjen e ujit dhe plotëson nevojat sanitare të kompsnisë, pompa përmes sistemit të tubacionit të instaluar në objekt bënë furnizimin me ujë të objektit në mënyrë të pa ndërprerë në repartin e impiantit.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujrave, shkarkimet e ujrave sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	Ujëra të ndotura mundë të konsiderohen ujërat e shkaktuara nga reshjet atmosferike, vajrat e ndryshme të cilat aksidentalisht derdhen në tokë nga makinat të cilat me vete bartin edhe një sasi të pluhurit të depozituar gjat kryerjes së punëve operacionale.
5.3.	Ndikimet në ujë	Ndikime negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajra e ndryshme të cilat derdhen aksidentalisht në tokë nga makinat transportuese dhe ato në fazën e ngarkimit Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor.
		Treguesit e ujrave të ndotura u cekën më lartë por nuk

5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor.	kemi ndonjë treguestë përhershëm sepse në ushtrimin e veprimtarive të lartëcekura nuk kemi ndotje të shkaktuara nga zhvillimi i punëve operacionale , por ajo ndotje vinte nga të reshurat të cilat janë periodike dhe na pamundësojnë që të kemi ndonjë të dhënë e cila mundë të konsiderohet vjetore.
5.3	Ndikimet në ujë	Ndikime negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen aksidentalisht në tokë nga makinat transportuese dhe ato në fazën e ngarkimit, Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor.
5.4	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor.	Treguesit e ujrave të ndotura u cekën më lartë por nuk kemi ndonjë treguestë përhershëm sepse në ushtrimin e veprimtarive të lartëcekura nuk kemi ndotje të shkaktuara nga zhvillimi i punëve operacionale , por ajo ndotje vinte nga të reshurat të cilat janë periodike dhe na pamundësojnë që të kemi ndonjë të dhënë e cila mundë të konsiderohet vjetore.

5.5.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Për shkak të natyrës së punës mundë të konkludojmë se nuk kemi të bëjmë me ujra të ndotura. Uji i cili përdoret për rrëzimin e pluhurit, është ujë i konsumuar dhe nuk është i kthyeshëm në proces kurse uji i cili shërben për nevojat sanitare të stafit të punëtorëve të kompanisë , grumbullohet në gropën septike të përgatitur nga kompania e cila në mënyrë periodike pastrohet nga kompanitë e specializuara..
5.7.	Raporimi	Raportet hartohen mbi bazën e të dhënave të monitorimit, regjistrave të mirëmbajtjes dhe dokumentacionit të menaxhimit mjedisor. Ato ruhen në arkivin e operatorit dhe vihen në dispozicion të autoriteteve kompetente gjatë inspektimeve ose sipas kërkesës zyrtare. Në rast të tejkalimit të vlerave kufitare të emisioneve ose konstatimit të një incidenti me ndikim në mjedis, operatori do të njoftojë menjëherë autoritetet kompetente dhe do të ndërmarrë masa korrigjuese për eliminimin e shkaqeve dhe rikthimin e parametrave mjedisorë brenda kufijve të lejuar.
	Lejet për shfrytëzim të ujit	

5.8		Nuk ka nevojë për leje të veçant të shfrytëzimit të ujit sepse gurthyesi i cili operon është brenda zonës së lokacionit të betonjerës dhe shfrytëzojnë ujin e njejt edhe pse në gurthyes sasia e ujit është e vogël.
5.9	Leje Ujëore për shkarkimin e ujërave të ndotura	Nuk ka nevojë për leje të veçant të shkarkimit të ujit sepse gurthyesi i cili operon është brenda zonës së lokacionit të betonjerës dhe shfrytëzojnë ujin e njejt edhe pse në gurthyes sasia e ujit është e vogël.
5.10	Masat për zvoglimin e ndotjes së ujrave	Nuk shkaktohen ujra të ndotura përveq uji që përdoret për pastrimin e mjeteve të punës i cili shkon në pusin sedimentues dhe më pas përdoret si ujë i ricikluar dhe ato të nyjeve sanitare
6. ZHURMA		
6.1	Burimet	Zhurma e shkaktuar gjatë operacionit për bluarjen e frakcioneve të gurit, nga pajimet teknologjike të agazhuara në gurthyes me seperacion, është e karakterit lokal dhe nuk mundë të ket ndonjë ndikim në

		zonat e banuara sepse në këtë zonë kemi edhe veprimtari të tjera afariste. Zhurma shkaktohet gjatë kryerjes së aktiviteteve të lartcekura,nga makinat që bluajn dhe seperojnë, e ngarkojnë lëndën, kamionët transportues etj. Shfrytëzimi i pajimeve bashkohore për kryerjen e punëve operacionale mundëson që zhurma në në hapsirën ku është vendosur baza për prodhimin e betonit, mesi ku punohet është shumë larg nga lokalitetet e banuara dhe nuk paraqesin problem për komunitetin. Kompania ka matjet e zhurmës nga laboratori dhe të njejtat do ja bashkangjesim projektit si paterial përcjellës në shtojcën grafike
6.2	Kontrolli dhe matjet	Do ta japim në formë tabelare nivelin e zhurmës në raport me distancën, nëse është e nevojshme kompania është e gatshme që të bëjë matjen e nivelit të zhurmës duke i ju referuar tabelës krahasuese me parametra të

		lejuar të nivelit të zhurmës në raport me distancën. Zhurma / Distanca(m): 10, 50, 100, 500 90dB-niveli Për paisje moderne: 59, 45, 39, 25
6.3	Raportimet	Siq u cek më lartë kjo zonë është e karakterit të përzier industrial dhe se zhurma nuk paraqet problem për rrethinën sepse edhe objektet tjera rrethuese janë objekte afariste prodhuese , prandaj kompania nuk ka nevojë për raportime të posaqme.

7. TOKA		
7.1	Ndikimet në tokë	Në Lokacionin e të gurthyesit, fusha operacionale është pothuaj e betonuar dhe si e tillë është kufizuar nga ndikimet e mëtutjeshme negative.

		Ndikim të madh negativ ka derdhja aksidentale e vajrave lybrifikues të cilat nëse bien aksidentalisht në tokë janë të dëmshme për natyrën pasi që edhe koha e dekompozimit të tyre është e madhe. Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.
7.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve në tokë gjat kryerjes së punëve operacionale, në kompani do të ndërmerren këto masa: ❖Masa bimore e larguar pas përfundimit të punës do të kthehet konform projektit të VNM. ❖Janë ndërmarrë masa që vajrat e makinave dhe të pajimeve tjera të mos derdhen në

		tokë. ❖Nëse për shkak të ndonjë avarie në fazën e prodhimit, duhet bërë largimi i vajit nga ndonjë makinë, atëherë duhet patur kujdes që vaji të derdhet në ndonjë enë jo ujëlëshuese e cila duhet të vendoset nën makinën e cila riparohet. ❖Të gjitha mbeturinat e ngurta që krijohen në lokalitet gjatë proçesit të punës, grumbullohen dhe të klasifikohen sipas llojit: si p.sh. ato metalike të grumbullohen në vende të posaçme e më pastaj ti shiten kompanive të licencuara për ripërpunimin e tyre kurse ato që mbeten për nevojat e Kompanisë të vendosen nëpër kontenjer të veçant në mënyrë që të mos jenë shkaktar të ndotjes së ambientit. ❖Mbeturinat e lëngëta që krijohen me rastin e

		ndrrimit të vajrave nëpër makina vendosen nëpër kontejner të veçant, e më pas tu jepen kmpanive të licencuara të cilat merren me riciklimin e tyre por këto punë kryhen në repartin e fabrikës.
7.3	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Rikultivimi i hapesires ku ka punuar gurthyesi duhet të trajtohet ne perputhje me kerkesat bashkohore të mbrojtjes dhe rikultivimit të mjedisit, të cilin duhet pa si nje prioritët të rendesishem edhe ne ketë lokalitët ku zhvillohet aktivitëti prodhues. Nga proqeset tëknologjike per prodhimin e frakcioneve të gurit do të krijohen substratë qe i takojne katëgorise se tokave të demtuara d.m.th substratë të pa pershtatshme per rikultivim.

		Substratët me perberes të reres, qe pa tjetër duhet ti nenshtrohen rehabilitimit gjere ne masen e permiresimit të pjeserishem të vetive të tyre dhe krijimit ose zevendesimit të tije me atë të rrethines ashtu qe të krijohet nje substrat produktiv i pershtatshem per rikultivimin bujqesore dhe atë malore. Rikultivimi i ketyre siperfaqeve të demtuara perfshine revitalizimin ne tërsi të hapesirave të shfrytëzuara dhe demtuara nga punimet prodhuese. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qellimi i rikultivimit- i cili ndikon qe pas perfundimittëpunimeveoperacionale,siperfaqe ve të degraduara prape tu kthehet funksioni i tyre primar (prodhimi i biomases), dhe keshtu zvoglohet ndikimi negativ i ketije projekti ne ekosistëm.Planifikohet qe toka ne zonën e

		gurthyesit të rikultivohet duke iu pershtatur gjendjes se perafert me atë të rrethit. Rikultivimi eshtë i lidhur me aktivitëtët prodhuese, perkatësisht perfundimin e puneve dhe shpalljen e aktivitëtit prodhues, të mbyllur. Të gjitha aktivitëtët e lartëshenuara synojne objektivat e rikultivimit qe kane keto qellime: ❖ Prodhimin e biomasës ❖ Rehabilitimin e peisazhit dhe kthimin e pamjes vizuele në harmoni me formën relefore të terenit. ❖ Kthimin e profilit pedologjik të tokës së degraduar me rastin e punimeve operacionale. ❖ Zgjërimi i kapacitetit filtrues natyror të ajrit. ❖ Mveshja i sipërfaqeve gjveshura si pasojë e punimeve operacionale. ❖ Krijimin e një pejsazhi të bukur, të përafërt me ate të natyrës për rreth.

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE		
8.1	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	Raportin e VNM-së për **gurthyesin me seperacion të kompanisë "ETEM TRADE" në Petrovë – Prizren** do të bëhet ndarja duke përdorur klasifikimin sipas **Katalogut Evropian të Mbetjeve (EWC/LoW)**, i cili përdoret edhe në Kosovë. Gjatë funksionimit të impiantit të prodhimit të frakcioneve nga guri të kompanisë **"ETEM TRADE"** do të gjenerohen mbetje jo të rrezikshme dhe, në sasi të kufizuara, mbetje të rrezikshme që lidhen me mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve. Të gjitha mbetjet do të klasifikohen sipas Katalogut Shtetëror të Mbetjeve (i harmonizuar me Katalogun Evropian të Mbetjeve – EWC/LoW) dhe do të menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kodet e mbetjeve (EWC/LoW) me numra do të ipen në shtojën grafike të projektit.

8.2	Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Mbetjet do të grumbullohen në mënyrë të selektuar, në kontejnerë të përshtatshëm dhe të etiketuar sipas llojit të mbetjes. Mbetjet e rrezikshme do të ruhen përkohësisht në një zonë të veçantë, të mbuluar, me dysheme të papërshkueshme nga uji dhe me masa mbrojtëse kundër rrjedhjeve. Dorëzimi i mbetjeve do të kryhet vetëm tek operatorë të licencuar, ndërsa për çdo transferim do të mbahet dokumentacioni përkatës në përputhje me kërkesat ligjore. Kompania do të mbajë evidencë të vazhdueshme për llojin, kodin, sasinë, mënyrën e trajtimit dhe destinacionin e secilës kategori mbetjesh, me qëllim sigurimin e gjurmueshmërisë dhe respektimin e detyrimeve ligjore për menaxhimin e mbetjeve.
8.3	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Kompania **"ETEM TRADE"**, gjatë funksionimit të impiantit të bluarjes dhe seperimit të gurit gëlqeror në

		Petrovë – Prizren, do të zbatojë një sistem të integruar të menaxhimit të mbetjeve, me qëllim parandalimin e ndotjes së mjedisit, minimizimin e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe rritjen e shkallës së ripërdorimit dhe riciklimit të tyre. Menaxhimi i mbetjeve do të realizohet në përputhje me hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve: **parandalim, ripërdorim, riciklim, rikuperim dhe, si alternativë e fundit, asgjësim**. Mbetjet e procesit të bluarjes, llumi nga sedimentimi dhe materialet inerte do të grumbullohen në zona të caktuara dhe, kur karakteristikat teknike e lejojnë, do të ripërdoren në procesin e prodhimit ose si material mbushës. Mbetjet që nuk mund të ripërdoren do t'u dorëzohen operatorëve të licencuar për riciklim ose trajtim. Ambalazhet prej letre, kartoni, plastike, druri dhe metali do të grumbullohen në mënyrë të ndarë në kontejnerë të etiketuar dhe do të dorëzohen për

		riciklim te operatorët e licencuar. Paletat prej druri që janë në gjendje të mirë do të ripërdoren, ndërsa ato të dëmtuara do të dërgohen për riciklim ose trajtim të autorizuar. Mbetjet e rrezikshme, si vajrat e përdorur, filtrat e vajit, materialet absorbuese të kontaminuara, bateritë dhe mbetjet e tjera të krijuara gjatë mirëmbajtjes së makinerive, do të ruhen në kontejnerë të mbyllur dhe të etiketuar, mbi sipërfaqe të papërshkueshme nga uji dhe në zona të mbrojtura nga reshjet atmosferike. Këto mbetje nuk do të përzihen me mbetjet e zakonshme dhe do të dorëzohen vetëm tek operatorë të licencuar për trajtim ose rikuperim. Ujërat teknologjike nga larja e pajisjeve do të trajtohen në basene sedimentimi, ku do të ndahet llumi nga uji. Uji i trajtuar do të ripërdoret në procesin teknologjik ose për kontrollin e pluhurit, ndërsa llumi i sedimentuar do të trajtohet si mbetje inerte ose do të rikuperohet,

		nëse është teknikisht i përshtatshëm. Në impiant do të zbatohet grumbullimi i ndarë i mbetjeve në burim, duke vendosur kontejnerë të veçantë për secilën kategori mbetjesh. Të gjitha kontejnerët do të jenë të identifikuar me etiketa përkatëse dhe do të vendosen në zona të përshtatshme, duke parandaluar përzierjen e mbetjeve dhe rrezikun e ndotjes së tokës dhe ujërave.
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër-kontratë me kompaninë e Licencuar	Kompania "ETEM TRADE" nuk do të kryejë trajtimin ose riciklimin përfundimtar të mbetjeve brenda impiantit, përveç grumbullimit të ndarë dhe, kur është e mundur, ripërdorimit të materialeve inerte në procesin teknologjik. Të gjitha mbetjet që nuk mund të ripërdoren do t'i dorëzohen për trajtim, rikuperim, riciklim ose asgjësim operatorëve të licencuar për menaxhimin e mbetjeve, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës.

8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Plani për Menaxhimin e Mbeturinave ka për qëllim sigurimin e grumbullimit, klasifikimit, ruajtjes së përkohshme, transportit, trajtimit, riciklimit dhe asgjësimit të mbetjeve të gjeneruara gjatë funksionimit të impiantit të prodhimit të betonit, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe kushtet e lejes mjedisore. **Objektivat** • Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbetjeve. • Grumbullimi i ndarë i mbetjeve sipas llojit. • Maksimizimi i ripërdorimit dhe riciklimit të materialeve. • Menaxhimi i sigurt i mbetjeve të rrezikshme. • Parandalimi i ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit. • Sigurimi i gjurmueshmërisë së të gjitha mbetjeve deri në trajtimin përfundimtar.

		Klasifikimi i mbetjeve Mbetjet do të klasifikohen sipas Katalogut Shtetëror të Mbetjeve (i harmonizuar me Katalogun Evropian të Mbetjeve – EWC/LoW) dhe do të ndahen në: • mbetje inerte (mbetje të gurëve, agregate, llum sedimentimi); • mbetje të riciklueshme (letër, karton, plastikë, metal, dru); • mbetje komunale; • mbetje të rrezikshme (vajra të përdorur, filtra, materiale absorbuese të kontaminuara, bateri). **Ripërdorimi dhe riciklimi** • Mbetjet e gurëve dhe materialet inerte, kur është teknikisht e mundur, do të ripërdoren në procesin teknologjik ose si material mbushës. • Ambalazhet prej letre, kartoni, plastike, metali dhe druri do të ndahen në burim dhe do të dorëzohen për riciklim.

		• Ujërat teknologjike do të trajtohen në basene sedimentimi dhe do të ripërdoren për larjen e pajisjeve ose kontrollin e pluhurit. Plani për Menaxhimin e Mbeturinave do të rishikohet periodikisht ose sa herë që ndryshojnë proceset teknologjike, llojet e mbetjeve të gjeneruara, kërkesat ligjore ose kushtet e lejes mjedisore, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore të kompanisë.
	Raportimi	Kompania "ETEM TRADE" do të mbajë një sistem të rregullt të raportimit dhe dokumentimit për të gjitha aktivitetet që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe kushtet e lejes mjedisore. Raportimi do të përfshijë të dhëna mbi llojin e mbetjeve të gjeneruara, kodin sipas Katalogut Shtetëror të Mbetjeve, sasinë, mënyrën e grumbullimit, ruajtjes së përkohshme, transportit, trajtimit, riciklimit

		ose asgjësimit, si dhe emrin e operatorit të licencuar që ka kryer pranimin e tyre. Për çdo dorëzim të mbetjeve do të ruhen dokumentet shoqëruese, përfshirë kontratat me operatorët e licencuar, fletëdorëzimet, faturat, dëshmitë e pranimit dhe çdo dokument tjetër që vërteton trajtimin ose riciklimin e mbetjeve. Këto dokumente do të arkivohen dhe do të jenë në dispozicion të autoriteteve kompetente gjatë inspektimeve.
9. RREZIKU NGA AKSIDENTET		
9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Aktiviteti i gurëthyesit me seperacion, dhe mekanizmi punues është i mirëmbajtur si dhe nën mbikqyerjen e stafit profesional që punon në kuadër të kësaj kompanie. Pasi në lokalitetin ku prodhohen frakcionet ezallit nga guri gëlqeror nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, atëherë rreziqet e mundshme që mund të ndodhin

		në vend pune mund të jenë të natyrës së ndryshme gjatë proçeseve teknologjike si: Gjatë proçesit të mbushjes së autocisternës me ujë. Gjatë transportit të frakcioneve nga kompanitë e ndryshme Gjatë riparimeve dhe mirëmbajtjes
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Puna operacionale në kompaninë " ETEM TRADE " nuk bazohet në materje të cilat mundë të kualifikohen si të rrezikshme.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Për evitimin e rreziqeve nga aksidenteve gjat prodhimit të frakcioneve të zallit nga guri gëlqeror nga procesi i bluarjes etj duhet: ❖ Është bërë plani i mbrojtjes nga zjarri. ❖ lokaliteti i fushës është i thurur. ❖ Jan marrur të gjitha masat e sigurisë në përputhje me ligjin për siguri në punë, mbrojtjë të shëndetit të punëtorëve dhe mjedisit në punë.

9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Për monitorimin dhe raportimin e ndikimeve direkte të aktiviteteve punuese, të proqeseve teknologjike, duke u bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis të cilat janë ndikimi në tokë, në ajër dhe ujë të cilat do të ishin minimale pas marrjes së masve për zvogëlimin e këtyre ndikimeve. Për këtë arsye parashihet një program monitorues për për të raportuar mbi gjendjen e sigurisë lidhur me, prodhimin transportin dhe ngarkimin e lëndës minerale.
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	• Ambientet e kompanisë " ETEM TRADE " janë të pajisura me aparatet për shuarjen e zjarreve si preventivë në rast të ndojë aksidenti . Për shuarjen e zjarrit të përdoren aparatet mobile zjarrfikëse që duhet të vendosen në vendet ku do të jenë më efikas psh. në hapësirat ku gjendet lëndët djegëse (nafta, vajrat lybrifikues)

		dhe ne hapësirat ku mbahen mbeturinat nga letra, si dhe ne hapësirat prodhuese. Zakonisht vendosen dy aparate mobile zjarrfikëse të tipit (S9) dhe një arkë me rërë. • Janë të rregulluara sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe jan siguruar aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë. • Shiriti transportues i frakcioneve për beton është i siguruar me rrethoja metalike anësore. Oborri i fabrikës është i thurur mirë nga të gjitha anët dhe i kontrolluar mirë 24 orë/ditë me qëllim të minimizimit të paraqitjes së ndonjë aksidenti të mundshëm.

		 Aparat për shuarjen e zjarrit, 5kg dioksid carboni
10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT		
10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Ndërprerje momentale të punës mundë të krtë përshkak të mungesës së energjisë elektrike , defekteve të papritura në repartin e përpunimit e për pasojë vie deri te ndërprerja e punës në gurthyes.
10.2.	Ndërprerja e punës	Te ndërprerja e punës mundë të vi pë rshkak të mosrespektimit të detyrimeve që dalin nga ligjet e

		lartëcekura në fuqi apo edhe për afarizëm jo të sukseshëm të kompanisë.

Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut

- Në rast të mos funksionimit të sistemit të makinerisë për bluarje dhe seperim, të spërkatjes me ujë. Bëhet mbikëqyrje e rregullt dhe menaxhim sa më i mirë gjatë procesit për bartjen e gurit nga miniera,ngarkimit etj.
- Evidenca dhe shënimet duhet të mbahen sipas rekomandimeve që jepen ne Ligjin për Mbeturina Nr. 02/L-30 dhe Udhëzimeve administrative për mbeturina relevante të hartuara sipas rekomandimeve nga Ligjin për Mbeturina Nr. 02/L-30.

11. NDIKIMI I MUNDSHEM I NDOTJES NE SHENDETIN E NJERIUT

Në rast të mos funksionimit të sistemit të spërkatjes gjat fazës së prodhimit të frakcioneve të zallit nga guri gëlqeror , mundë të ndodhë ndotje e cila do të ishte e rrezikshme për shëndetin e njeriut por masat preventive të cilat u cekën më lartë mundësojnë një ambient të mbrojtur nga ndotja.

Personi pergjegjes per mjedis
Emri mbiemri---Samet Badalli
Nenshkrimi

Personi pergjegjes i kompanise
Emri Mbiemri—Sulltan Badalli
Nenshkrimi